

P.nr.1844/14

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari, Kujtim Krasniqi, me procesmbajtësen Qëndresa Alimehaj, në çështjen penale të të pandehures T.T, nga P, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 1 lidhur me par.6 të KPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.5691/13, të datës 22.08.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencën e prokurorit të shtetit Fatmire Cacaj, të akuzuara, me datën 15.07.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara;

T.T, nga i ati B dhe e ëma F, e lindjes R, e lindur më dt: *data e lindjes*, me vendbanim në rr.”H D” hy-./., ka të kryer Fakultetin e Farmacisë, e martuar, nënë e 2 fëmijeve, e gjendjes së mesme ekonomike, , me nr. personal *numri personal* shqiptare – shtetase e Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse, më datë 04.08.2013, rreth orës 13:02, në rrugën magjistrale Prishtinë-Fushë Kosovë, më saktë për ballë kazermës “Adem Jashari”, e pandehura T.T, gjersa ishte duke drejtuar automjetin e tipit “ Ford ”, me ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit ..-...-, nga pakujdesia ka shkel ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jetën dhe ka dëmtuar trupin e njeriut, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 126.1 të ligjit për siguri në komunikacionin rrugor, ashtu që nuk e ka mbajtur distancën e sigurisë së nevojshme të lejuar në mes të automjeteve me ç ‘rast, me pjesën e përparme të automjetit të saj e godet në pjesën e pasme automjetin e tipit “Mercedes 2”, me ngjyrë të bardhë, me targa të regjistrimit ..-...-, të cilën e drejtonte në kolonë tani i dëmtuari Muhamet Ibishi, ku si pasojë përveç dëmeve materiale shkaktohen edhe lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet,-

-me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve, 4, 7, 74, 75, 85 dhe 86, të KPRK, si dhe neneve 365; 498 dhe 499, të KPPK, i shqipton:

V Ë R E J T J E G J Y Q Ë S O R E

Me të cilën të akuzuara T.T, nga P, i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën vepër penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do t’i shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

Obligohet; e akuzuara që në emër të shpenzimeve të procedurës si: ekspertiza e ekspertit të komunikacionit në shumë prej **40.88 euro**, ekspertiza mjeko-ligjore në shumë prej **20 euro** si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **30 euro**, gjykatës t’ia kompensoj të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari: M.I, nga F K, rr."N S., për realizimin e kërkesës-pasurore juridike, udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.5691/13, të datës 22.08.2014, kundër T.T, nga P, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 1 lidhur me par. 6 të KPRK-së,

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin Fillestar më datë 12.07.2016, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

E pandehura në shqyrtimin fillestar, me vullnet të plotë dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorisë së shtetit, PP.II.nr.5691/13, të datës 22.08.2014.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i prokurorisë Themelore në Prishtinë- dep. i përgjithshëm Fatmire Cacaj lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se, pranimi i fajësisë nga e pandehura T.T për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës PP.II.nr.5691/13, të datës 22.08.2014, është në pajtueshmëri të plotë me nenin 248 të KPP-së, poashtu lidhur me provat dhe faktet të cilat mbështesin këtë aktakuzë. I ka propozuar gjykatës që të pandehuren T.T, ta shpallë fajtorë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe t'a dënoj sipas ligjit, gjithashtu i ka propozuar gjykatës që me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit të merr parasyshë rrethanat lehtësuese dhe rënduese sipas nenit 73 të KPRK-së.

E pandehura deklaroj se për këtë vepër penale ndihet fajtorë dhe përgjegjëse, se është penduar shumë për atë çka ka ndodhur, dhe i premtoj gjykatës se do të jem më e kujdesshme në komunikacion, i propozoj gjykatës që gjatë matjes së dënimit të më shqiptoj një dënim sa më të butë që është i mundur.

Nga thëniet e vet të pandehurës në shqyrtimin fillestar u vërtetua se ajo me datë kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj saj ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë ekspertiza e komunikacionit dhe ekspertiza mjeko-ligjore si dhe foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurës formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së, për të cilën akuzohet e pandehura, andaj gjykata të njëjtën e shpalli fajtorë, pasi qe gjeti se penalisht është e përgjegjshme dhe e gjykoj si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se: e pandehure e pranoi fajësinë për veprën penale, se ishte korrekte dhe me sjellje korrekte në gjykatë, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, është nënë e dy fëmijëve, dhe se i ka premtuar gjykatës së më nuk do

të përsërisë vepra penale, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese nuk gjeti, dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 50 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73.par.2, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikoj te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, palët e dëmtuar janë udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr.1844/14, të dt:15.07.2016

Sekretarja juridike,
 Qëndresa Alimehaj

Gjyqtari,
 Kujtim Krasniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.